

Aspiratorët EC

Në ditët e sotme vëmëndja e gjithë botës, vecanërisht e Europës (Normativa 2009/125/EC e Bashkimit European), Kanadasë, Australisë, Zelandës së Re etj., është e përqëndruar në lëvizjen “ Teknologjia e Gjelbër” për Kursimin e Energjisë dhe Mbrojtjen e Ekosistemit . Qeveritë promovojnë dhe stimulojnë të gjitha llojet e teknologjive që mundësojnë kursimin e energjisë dhe nxjerrin akte të ndryshme legjislative për konsumin e energjisë dhe reduktimin e emetimit të CO2. Tashmë të gjitha kompanitë ndërtuese janë të detyruara të përdorin materiale eficiente dhe të sigurt në të gjitha stadet e projekteve.

Aktualisht, industria e ventilimit prodhon aspiratorë me electromotor të teknologjisë EC (maksimumi i mundshëm) teknologji e cila po zbatohet nga shumica e prodhuesve. Të rejat e Teknologjisë janë: Ndjekja e *Teknologjisë së Gjelbër*, respektimi i Normativës 2009/125/EC, ulja e kostove së ndërtuesve dhe konsumatorëve.

Përse aspiratorë EC?

Elektromotorët EC (të komanduar në mënyrë elektronike) janë elektromotorë që kanë të vendosur në rotor magnet të përhershëm dhe përdorin aparatura elektronike për të kontrolluar voltazhin dhe intensitetin e aplikuar.

Për ata që ende janë të pasigurtë se përse duhet ta zgjedhin, duhet të dine se teknologjia EC synon uljen e konsumit elektrik dhe kombinon rryma elektrike nga dy teknologji, ajo AC dhe DC, duke sjellë më të mirën e të dyjave. Kjo do të thotë se elektromotori funksionon me rrymë elektrike të teknoklogjisë DC dhe me furnizuesin e energjisë së teknologjisë AC.

Me pak fjalë:

1. Aspiratorët EC janë deri në 30% më eficient se aspiratorët AC.
2. Aspiratorët EC kanë jetëgjatësi.
3. Aspiratorët EC kanë fushë më të gjërë përdorimi.
4. Aspiratorët EC janë lehtësisht të kontrollueshëm (0-10V)
5. Aspiratorët EC kërkojnë më pak mirëmbajtje.
6. Aspiratorët EC punojnë edhe me furnizues energjie 50Hz dhe me 60Hz.

Aspiratorët EC janë deri në 30% më eficient se aspiratorët AC, madje kanë eficensë më të lartë ndërkohë që punojnë pjesërisht.

Shkalla e eficensës së aspiratorëve EC lëviz nga 80% deri në 90%. E parë në perspektivë, një elektromotor me induksion tre fazor ka maksimumi 75% eficence dhe PSC (elektromotor me kondesator të shkëputur) ka një maksimum eficence ndërmjet 60% dhe 70%. Duke përdorur një elektromotor EC kurseni përgjatë gjithë kohës së përdorimit.

1. Aspiratorët EC kanë jetëgjatësi.

Eficensa e lartë e elektromotorëve EC nënkupton se elektromotoret punojnë me temperature të ulët dhe reduktojnë në mënyrë drastike sasinë e humbjes së nxehtësisë. Reduktimi i humbjes së nxehtësisë në nivelet e elektromotorit, ndikon gjithashtu në reduktimin e operacioneve në kondesator dhe kjo sjellë kursim të mëtejshëm energjie. Funkionimi me temperature të ulët përmirëson jetëgjatësinë e pjesëve të ngarkuara si pështjella dhe kushineta.

2. Aspiratorët EC kanë fushë më të gjërë përdorimi.

Aspiratorët EC kanë fushë më të gjërë përdorimi krahasuar me aspiratorët me elektromotor me induksion, pasi një electromotor i vetëm EC mund të zëvendësojë disa modele elektromotorësh me induksion. Në këtë mënyrë numri i modeleve të kërkuara nga një klient ulet ndjeshëm, duke pakësuar dhe lehtësuar magazinimin. Kjo është arsyeja kryesore pse linja e elektromotorëve EC përfshin më pak modele elektromotorësh krahasuar me homologët e tyre me induksion.

3. Aspiratorët EC janë lehtësisht të kontrollueshëm(0-10V)

Përsa i përket kontrollit të shpejtësisë dhe karakteristikave, për arsye se operimi i elektromotorit kontrollohet nga një program kompjuterik, elektromotorët EC i japin mundësinë klientit të optimizojë dhe integrojë elektromotorin, aspiratorin dhe komanduesin me aplikacion, si dhe të përfshijë disa karakteristika si: afishim të dhënash, volum konstant, shpejtësi te ndryshueshme, etj.

4. Aspiratorët EC kërkojnë më pak mirëmbajtje.

Duke qënë se elektromotorët EC funksionojnë me temperature të ulët dhe kanë më pak humbje energjie, ata kanë më shumë jetëgjatësi dhe kërkojnë më pak mirëmbajtje.